



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
Nr. Prot Broj. prot. 48	Nr. i faq. Br. str. -10-	Data: Datum: 02.08.2026
PRISTINE - PRISTINA - PRISTINA		

## RREGULLORE

# PËR MBIKËQYRJEN PROFESIONALE TË PUNËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË

Bazuar në paragrafin 1.4 dhe 1.6 të nenit 9 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, paragrafin 1.4, 1.6 të nenit 14 dhe paragrafit 1.1 të nenit 19 të Statutit të OIK, Kuvendi i Odës, në takimin e mbajtur me datë 27.02.2026, miratoi këtë:

## **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

Kjo rregullore përcakton mënyrën e mbikëqyrjes profesionale të punës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës, anëtarë të OIK, si dhe profesionistëve shëndetësorë sipas paragrafit 1.11 dhe 1.12 të nenit 69 të Ligjit për Shëndetësi.

### **Neni 2**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i mbikëqyrjes profesionale është të sigurojë që puna e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të kryhet në mënyrë profesionale, në përputhje me standardet e praktikës dhe etikës duke ofruar shërbime cilësore dhe të sigurta për pacientët.

### **Neni 3**

#### **Fushëveprimi**

1. Mbikëqyrja profesionale e punës së profesionistëve nga neni 1 të kësaj Rregulloreje zbatohet nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve Tjerë Shëndetësorë, si autoritet ligjor.
2. Në realizimin e mbikëqyrjes profesionale, OIK bashkëpunon me Ministrin e Shëndetësisë, Inspektoratin Shëndetësor dhe institucionet tjera kompetente.

## **II. KOMISIONI PËR MBIKËQYRJE PROFESIONALE**

### **Neni 4**

1. Mbikëqyrja profesionale organizohet nga Komisioni për Mbikëqyrjen Profesionale të Punës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), i cili emërohet nga Këshilli Drejtues.
2. Komisioni për mbikëqyrje profesionale përbëhet nga:
  - 2.1 Kryetari,
  - 2.2 Zëvendëskryetar dhe
  - 2.3 Tre anëtarë.
3. Kryetari/ja dhe anëtarët e Komisionit duhet të përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara me këtë rregullore për anëtarët e OIK që kryejnë mbikëqyrje profesionale.
4. Mandati i komisionit është i barasvlershëm me mandatin e anëtarëve të kuvendit të OIK-ut

## Neni 5

### Përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka këto përgjegjësi:
  - 2.1.I propozon Këshillit Drejtues listën e anëtarëve të mbikëqyrësve profesionalë;
  - 2.2.I propozon KD për miratim kriteret dhe standardet profesionale sipas të cilave do të kryhet mbikëqyrja;
  - 2.3.Përgatit planin vjetor të mbikëqyrjes profesionale, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues;
  - 2.4.Mban evidencën e mbikëqyrjeve të kryera dhe masave të propozuara;
  - 2.5.Përgatit raportin vjetor mbi mbikëqyrjen profesionale dhe ia paraqet Këshillit Drejtues, i cili e përcjell atë te organet kompetente;
  - 2.6.Një herë në vit i raporton Kuvendit të OIK për punën e Komisionit;
  - 2.7.Koordinon zbatimin e mbikëqyrjes me Inspektoratin Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, organet tjera kompetente dhe organet e mbikëqyrjes së brendshme të institucioneve Shëndetësore;
  - 2.8.Merr masat e nevojshme për paraqitjen e rasteve pranë organeve kompetente të OIK me qëllim të inicimit të procedurës për përgjegjësinë e Kodit të Etikës;
  - 2.9.Kryen detyra të tjera në përputhje me Statutin dhe aktet e përgjithshme të Odës.
2. Gjatë përgatitjes së listës së kandidatëve për mbikëqyrës profesional, Komisioni do të kujdeset që në listë të përfshihen mbikëqyrësit nga të gjitha profilet, me qëllim sigurimin e disponueshmërisë për mbikëqyrje.
3. Mënyra e punës së Komisionit rregullohet me Rregullore të veçantë të Punës.

## Neni 6

1. Me propozim të Komisionit, Këshilli Drejtues i OIK miraton listën e kandidatëve që kryejnë mbikëqyrjen profesionale.
2. Kandidatët që plotësojnë kërkesat e mëposhtme mund të emërohen si mbikëqyrës profesionalë:
  - 2.1 Arsimitim i përfunduar së paku niveli Bachelor në infermieri, mami dhe profesionist tjerë shëndetësor anëtarë të OIK;
  - 2.2 Licencë valide nga OIK;
  - 2.3 Të paktën 7 vjet përvojë pune në fushën përkatëse;
  - 2.4 Të mos kenë shkelje të Kodit të Etikës dhe të mos jenë të dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepra që lidhen me ushtrimin e profesionit.
  - 2.5 Të mos jetë i dënuar me vendim të plotfuqishëm nga gjykata për vepra penale.
3. Mbikëqyrësi nuk mund të ushtron mbikëqyrjen profesionale në institucionin ku është i punësuar.
4. Personi që kryen mbikëqyrjen profesionale duhet të ketë të paktën të njëjtin nivel kualifikimi profesional me profesionistin që mbikëqyret.

### **III. LLOJET E MBIKËQYRJES PROFESIONALE**

#### **Neni 7**

Mbikëqyrja profesionale mund të jetë:

1. Mbikëqyrje të rregullt profesionale;
2. Mbikëqyrje të jashtëzakonshme;
3. Mbikëqyrje kontrolluese-monitoruese.

#### **Neni 8**

##### **Mbikëqyrja e rregullt Profesionale**

1. Mbikëqyrja e rregullt profesionale kryhet sipas planit vjetor.
2. Plani miratohet nga Këshilli Drejtues, me propozim të Komisionit, jo më vonë se 15 dhjetori i vitit aktual për vitin pasardhës dhe publikohet në faqen zyrtare të OIK.
3. Mbikëqyrja e rregullt kryhet nga dy mbikëqyrës profesionalë; nëse është e nevojshme, me propozim të Kryetarit të Komisionit dhe në koordinim me Kryetarin e OIK, mund të angazhohen më shumë mbikëqyrës, si dhe ekspert të jashtëm.

#### **Neni 9**

##### **Mbikëqyrja e Jashtëzakonshme Profesionale**

1. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet jashtë planit vjetor, në rast ankese për punën e një anëtari të OIK gjatë kryerjes së detyrave. Kjo mbikëqyrje, vihet në veprim në rast të informacioneve dhe njohurive që tregojnë nevojën për ndërhyrje për evitimin e parregullsive profesionale dhe etike.
2. Komisioni, pas vlerësimit të ankesës, mund të konstatojë se nuk ka bazë për mbikëqyrje profesionale. Në këtë rast, i jep përgjigje me shkrim ankuesit, duke arsyetuar çdo pretendim të paraqitur.
3. Nëse konstatohet se trajtimi i pretendimeve të ankuesit është në kompetencë të organeve dhe autoriteteve tjera, ankesa i adresohet organit kompetent.
4. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet nga të paktën dy mbikëqyrës, numri i tyre mund të shtohet me propozimin e kryetarit të komisionit dhe vendimin e kryetarit të OIK.
5. Nëse nevojiten ekspertiza të veçanta jashtë listës së eksperteve të miratuar nga KD, kryetari i OIK mund të angazhojë ekspertë të jashtëm.

#### **Neni 10**

##### **Mbikëqyrja kontrolluese-monitoruese**

1. Kjo mbikëqyrje kryhet me qëllim monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë mbikëqyrjes së rregullt dhe të jashtëzakonshme.

2. Në rast se gjatë mbikëqyrjes së rregullt ose të jashtëzakonshme janë lënë vërejtje dhe masa për përmirësim, mbikëqyrja kontrolluese-monitoruese verifikon në çfarë mase ato janë zbatuar. Nëse ka dilema për zbatimin faktik, mbikëqyrësit kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje shtesë.

#### **IV. PËRMBAJTJA E MBIKËQYRJES PROFESIONALE**

##### **Neni 11**

1. Mbikëqyrja profesionale përfshin mbikëqyrjen e punës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë anëtarë të OIK në sektorin publik dhe privat, në lidhje me cilësinë dhe llojin e shërbimeve shëndetësore.
2. Mbikëqyrja përfshin:
  - 2.1 Organizimin e punës në ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe dokumentimi,
  - 2.2 Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë profesionale,
  - 2.3 Respektimin e procedurave, protokolleve dhe standardeve,
  - 2.4 Raportimin për komplikime,
  - 2.5 Respektimin e konfidencialitetit profesional,
  - 2.6 Respektimin e të drejtave të pacientit,
  - 2.7 Respektimin e kodit të etikës
  - 2.8 Respektimin e punës ekipore,
  - 2.9 Ruajtjen e reputacionit të institucionit,
  - 2.10 Përdorimin racional i produkteve dhe pajisjeve,
  - 2.11 Verifikimin e licencës dhe kompetencave,
  - 2.12 Edukimin e vazhdueshëm profesional,
  - 2.13 Lloje tjera shtesë të mbikëqyrjes sipas nevojës,
3. Mbikëqyrësit janë të detyruar të respektojnë kriteret e përcaktuara dhe të evidentojnë të gjitha faktet relevante në procesverbal.

#### **V. PROCEDURA E MBIKËQYRJES**

##### **Neni 12**

1. Procedura e mbikëqyrjes fillon me kërkesë me shkrim nga komisioni mbikëqyrës. Kërkesa i drejtohet me shkrim kryetarit/es së OIK-ut.
2. Kërkesa duhet të përmbajë:
  - 2.1 Emrin, mbiemrin dhe kualifikimet profesionale të mbikëqyrësit,
  - 2.2 Të dhëna mbi anëtarin e OIK ose institucionin që i nënshtrohet mbikëqyrjes;
  - 2.3 Përmbajtjen e mbikëqyrjes;
  - 2.4 Kohën e mbikëqyrjes;
  - 2.5 Përcaktimin e formës së mbikëqyrjes (rregullt, jashtëzakonshme ose kontrolluese-monitoruese);
  - 2.6 Të dhëna të tjera relevante.

3. Përfundimisht, në raste urgjente mund të bëhet kërkesë me gojë; kërkesa me shkrim duhet të lëshohet më së voni brenda 48 orëve.

### **Neni 13**

1. Në rastet e mbikëqyrjes së rregullt, paraprakisht duhet të njoftohet me shkrim ose me email anëtari i OIK, puna e të cilit mbikëqyret, si edhe personi përgjegjës i punëdhënësit, jo më vonë se 7 ditë para se të kryhet mbikëqyrja profesionale, me ç' rast duhet t'i dorëzohet njoftimi me shkrim sipas nenit 12 të kësaj Rregulloreje.
2. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme dhe kontrolli nga mbikëqyrësit mund të realizohen edhe pa paralajmërim në raste urgjente ndaj subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast të mbikëqyrjes nga paragrafi 2 i këtij neni, mbikëqyrësit duhet ta njoftojnë udhëheqësin e institucionit para fillimit të mbikëqyrjes.

### **Neni 14**

1. Anëtari i OIK, puna e të cilit i nënshtrohet mbikëqyrjes profesionale, dhe personat përgjegjës të punëdhënësit janë të detyruar të bashkëpunojnë me mbikëqyrësit profesional dhe ti japin të gjitha informacionet e kërkuara dhe të nevojshme.
2. Nëse anëtari i OIK-ut dhe personat përgjegjës të punëdhënësit refuzojnë të lejojnë kryerjen e mbikëqyrjes, personi që kryen mbikëqyrjen profesionale duhet ta konstatojë këtë në procesverbal, i cili shërben si bazë për njoftimin dhe iniciimin e rastit te Inspektorati Shëndetësor dhe te autoritetet tjera kompetente.
3. Refuzimi për të lejuar mbikëqyrjen profesionale, sipas paragrafit 2 të këtij neni, përbën shkelje të rëndë të detyrimit të anëtarit të Odës dhe ndaj tij do të iniciohen procedurat e përgjegjësisë etike dhe ligjore.

### **Neni 15**

1. Në rastet kur institucioni shëndetësor është i mbyllur, ose anëtari i Odës ndaj të cilit ushtrohet mbikëqyrja profesionale dhe personat tjerë përgjegjës nuk gjenden në vendin e punës në kohën e mbikëqyrjes profesionale, që si rrjedhojë e bën të pamundur kryerjen e mbikëqyrjes profesionale, mbikëqyrësit profesionalë duhet ta konstatojnë këtë rrethanë në procesverbal dhe për këtë duhet të informojnë Inspektoratin Shëndetësor dhe organet tjera kompetente.

### **Neni 16**

1. Anëtari i OIK, puna e të cilit mbikëqyret, përgjegjësi i institucionit dhe personat tjerë përgjegjës kanë të drejtë të marrin pjesë në zbatimin e mbikëqyrjes profesionale.
2. Në rast se personat përgjegjës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk janë të pranishëm, dhe nuk kanë autorizuar persona tjerë të jenë të pranishëm gjatë mbikëqyrjes profesionale,

do të konsiderohet se kjo pengon kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe do të ndërmerren veprime në përputhje me nenin 15 të kësaj Rregulloreje.

### Neni 17

1. Gjatë mbikëqyrjes profesionale mbahet procesverbal me shkrim.
2. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:
  - 1.1 Vendi, data dhe ora e fillimit dhe e mbarimit të mbikëqyrjes nga mbikëqyrësit,
  - 1.2 Lloji i mbikëqyrjes,
  - 1.3 Të dhënat e mbikëqyrësve,
  - 1.4 Të dhëna në lidhje me institucionin shëndetësor ku është i punësuar anëtari i OIK,
  - 1.5 Të dhëna mbi anëtarin e OIK ndaj të cilit kryhet mbikëqyrje profesionale,
  - 1.6 Të dhëna për personat e tjerë të pranishëm gjatë mbikëqyrjes,
  - 1.7 Përshkrimin e rrjedhës dhe përmbajtjes së veprimeve të ndërmarra në kryerjen e mbikëqyrjes,
  - 1.8 Përshkrimin e deklaratave të bëra dhe dokumenteve të përdorura,
  - 1.9 Mangësitë e identifikuara dhe masat e propozuara, si dhe afatin e fundit për eliminimin e mangësive të identifikuara,
  - 1.10 Vërejtje nga anëtari që është subjekt i mbikëqyrjes profesionale ose nga personat tjerë përgjegjës,
  - 1.11 Të dhëna të tjera relevante.
3. Procesverbali i hartuar i lexohet personave të pranishëm gjatë mbikëqyrjes profesionale.
4. Pas përpilimit të procesverbalit, do të deklarohet se procesverbali është lexuar dhe se nuk janë bërë kundërshtime, nëse janë bërë kundërshtime, përmbajtja e tyre do të deklarohet shkurtimisht.
5. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga personi/personat që kryejnë mbikëqyrjen profesionale, anëtari i OIK puna e të cilit mbikëqyret dhe personi përgjegjës nëse ata kanë marrë pjesë në mbikëqyrjen profesionale.
6. Personat që kanë dhënë deklaratat duhet ta nënshkruajnë procesverbalin menjëherë pas deklaratës së tyre dhe në fund të çdo faqeje në të cilën përmbahet deklarata e tyre.
7. Asgjë nuk mund të ndryshohet ose shtohet në procesverbalin e nënshkruar dhe të përfunduar. Ndryshimet në procesverbalin e përfunduar duhet të futen si shtojcë në procesverbal dhe të nënshkruhen nga zyrtari dhe personi me propozimin e të cilit është bërë ndryshimi.
8. Nëse ndonjëri nga personat e pranishëm refuzon të nënshkruajë procesverbalin ose largohet nga vendi i mbikëqyrjes profesionale, para përfundimit të procesverbalit, ky fakt duhet të deklarohet në procesverbal, si dhe arsyet për refuzimin e nënshkrimit.
9. Procesverbali duhet të jetë i hartuar në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe me këtë Rregullore.
10. Një kopje e procesverbalit duhet të mbahet nga anëtari i OIK që mbikëqyret, nga përfaqësues i institucionit dhe nëse mbikëqyrja është kryer mbi një numër të

paspecifikuar anëtarësh, të gjithëve u jepet nga një kopje e procesverbalit dhe një kopje mbahet nga ata që kryejnë mbikëqyrjen.

11. Mbikëqyrësit që kryejnë mbikëqyrje profesionale duhet të plotësojnë formularin e procesverbalit në përputhje me llojin e mbikëqyrjes dhe të dhënat që kanë në dispozicion.
12. Formulari i procesverbalit është pjesë e kësaj rregulloreje (Shtojca I).

### **Neni 18**

1. Në rast të konstatimit të shkeljeve profesionale dhe etike të anëtarëve të OIK dhe personave tjerë fizikë dhe juridikë të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje, eliminimi i të cilave kërkon urgjencë, personi që kryen mbikëqyrjen profesionale mund të bëjë kërkesë gojore për zbatimin e masave të nevojshme për të eliminuar mangësitë profesionale të identifikuara.
2. Vendimi me gojë duhet të shënohet në procesverbal.
3. Anëtari i OIK nuk mban përgjegjësi në rastet kur punëdhënësi nuk ka siguruar kushtet e përcaktuara me ligj për përmbushjen e obligimeve profesionale.

## **MENDIMI PROFESIONAL**

### **Neni 19**

1. Pas kryerjes së mbikëqyrjes, Komisioni bën vlerësimin përfundimtar dhe, në afat prej 7 ditë pune, dorëzon subjektit të mbikëqyrur raportin përfundimtar mbi të gjeturat.
2. Raporti i dorëzohet anëtarit të OIK dhe personit përgjegjës të institucionit shëndetësor ose të autorizuarit të tij, që ishin subjekt i mbikëqyrjes profesionale.
3. Në rast të mangësive të identifikuara në punën profesionale të institucionit shëndetësor ose anëtarit të OIK, Komisioni i përshkruan ato në mendimin e ekspertit dhe përcakton masat për zbatimin e tyre, si dhe afatin kohor për përmirësimin e tyre.
4. Afati për ekzekutimin e masave të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni nuk mund të kalojë 3 muaj.

### **Neni 20**

1. Subjektet e cekura në nenin 11, paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje mund të japin përgjigje me shkrim ndaj raportit të komisionit në afat prej 8 ditësh nga marrja e konstatimit.
2. Komisioni për Mbikëqyrjen Profesionale i Odës së Infermierëve të Kosovës, në afat prej 15 ditësh, vendos për pretendimet e theksuara në përgjigjen me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

## **Neni 21**

1. Nëse subjektet nga neni 11, paragrafi 1 i kësaj Rregulloreje nuk paraqesin raport brenda afatit të caktuar në paragrafin 4 të nënti 19, duke deklaruar se mangësitë profesionale të identifikuara janë përmirësuar, ose nëse komisioni e konsideron të nevojshme, komisioni është i detyruar ti propozojë kryetarit të Odës kryerjen e një mbikëqyrjeje profesionale kontrolli.
2. Nëse mbikëqyrja profesionale e kontrollit përcakton se mangësitë e identifikuara nuk janë përmirësuar, personat që kryejnë mbikëqyrjen profesionale janë të detyruar ta njoftojnë komisionin, i cili përgatit raport me rekomandime për kryetarin e Odës jo më vonë se 8 ditë pas kryerjes së mbikëqyrjes së kontrollit, me qëllim që të iniciohen masat për shkelje etike dhe ligjore ndaj anëtarit të Odës.

## **Neni 22**

1. Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt, të jashtëzakonshme ose kontrolluese identifikohen mangësi që janë brenda përgjegjësive të OIK, komisioni është i detyruar ti paraqesë një raport organit kompetent të Odës me qëllim të fillimit të procedurës për konstatimin e shkeljeve etike dhe ligjore, jo më vonë se 8 ditë pas marrjes së procesverbalit.
2. Nëse gjatë mbikëqyrjes së rregullt, të jashtëzakonshme ose kontrolluese identifikohen mangësi që janë në kompetencë të Inspektoratit Shëndetësor ose të institucioneve tjera kompetente, Komisioni është i detyruar të njoftojë këto organe në afat prej 8 ditësh nga dita e konstatimit të shkeljeve të evidentuara në procesverbal.

## **VI. PËRGJEGJËSITË E MBIKËQYRËSVE PROFESIONALË**

### **Neni 23**

1. Mbikëqyrësit që kryejnë mbikëqyrjen profesionale janë përgjegjës:
  - 1.1 Nëse, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, nuk japin udhëzime të qarta për përmirësimin e mangësive të identifikuara;
  - 1.2 Nëse i tejkalojnë kompetencat e tyre;
  - 1.3 Nëse nuk i iniciojnë me kohë procedurat sipas nenit 21 të kësaj Rregulloreje.
2. Për shkak të lëshimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, komisioni mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të OIK që personi që kryen mbikëqyrjen profesionale të hiqet nga Lista e Personave që Kryejnë Mbikëqyrjen.

## **VII. MJETET PËR ZBATIMIN E MBIKËQYRJES PROFESIONALE**

### **Neni 24**

1. Fondet për kryerjen e mbikëqyrjes sigurohen nga buxheti i OIK.
2. Lartësia e kompensimit për komisionin dhe mbikëqyrësit profesional, përcaktohet me vendim të veçantë të këshillit drejtues.

3. Kompensimi për ekspertë të jashtëm bëhet në mënyrë analoge me tarifatat zyrtare të fushave përkatëse.

## VIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 23

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i OIK
2. Zbatimi i kësaj rregullore fillon nga 1 korriku i viti 2026
3. Pjesë e kësaj rregullore do të jen edhe shtojcat e standardizuara të mbikëqyrjes.

Kryetare e OIK  
Nexhmije Gori

